



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:304510

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06787499

2024:304511

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.M. nga ....., për shkak të veprës penale vjedhje në tentativë nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1756/24 të datës 28.10.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 27.01.2025, në prani të Prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29.01.2025 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri A.M., nga i ati Xh., e ëma N., e vajzërisë M., i lindur më datën ....., në ....., ku edhe jeton me adrese rruga “...”, punëtor, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë, ndaj tij udhëhiqen procedura tjera penale

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën Me datë 06 Tetor 2024, rreth orës 10:30 në ....., rruga “...”, përkatësisht në “...” i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ka

tentuar t'ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit R. L., në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari kishte qenë duke ecur së bashku me bashkëshorten e tij, i pandehuri arrin që t'ia merr të hollat nga gjepi i pasme të pantallonave në shumë prej 580 Euro, por që menjëherë zbulohet nga ana e të dëmtuarit dhe i lëshon të hollat në tokë.

**-Me çka ka kryer veprën penale Vjedhje në tentativë nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 313 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364, 452, 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurën e :

## **G J Y K O N**

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 /tre/ muaj dhe me dënim në të holla në shumë prej 300 € /treqind euro/. Dënimi i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë është e obliguar ta paguajnë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se e pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'u llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuari R. I. L. nga ....., rruga "...", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr. 1756/24 të datës 28.10.2024, ka ngarkuar të pandehurin për veprën penale vjedhje në tentativë

nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar e pandehura gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 27.01.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza, për veprën penale Vjedhja në tentativë nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, e di që kam gabuar dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepra penale apo vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit ka deklaruar, pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që ky pranim është bërë konform nenit 242 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare duke u mbështetur në prova dhe fakte që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj, përkitazi për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, ndërsa posaçërisht si rrethana rëndësuese të merr për bazë faktin se i njëjti është i njohur për organet e drejtësisë ka të proceduar një numër bukur të

madh të veprave penale në prokurori e disa prej tyre janë ngritur edhe aktakuza dhe kanë përfunduar edhe me aktgjykim të formës së prerë, dhe të njëjtit të i shqipton një sanksion penal të paraparë me ligj që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallen e përgjegjësisë, rrezikshmërisë si dhe pasojën e shkaktuar me këtë vepër penale

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti fillestar i incidentit, i datës 06.10.2024, Raporti i Oficerit, të datës 06.10.2024, të dhënat nga data baza e Policisë së Kosovës, përkitazi me të kaluarën kriminale e të pandehurit si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje në tentativë nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe iu shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë kesi lloj veprë penale apo të ngjashme, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë

rrethanë rënduese edhe përkundër asaj se i pandehuri ka deklaruar se edhe më parë ka qenë dënuar për veprë të njëjtë penale, prokuroria nuk ka arritur të në shqyrtim gjyqësor ta dëshmojë këtë me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, andaj gjykata në këtë rast përveç rrethanave të sipërpërmendura vlerësoj edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**2024:304511, i datës 29.01.2025**

**Zyrtarja ligjore:**  
**Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.